

BRUNILDA SPIRO

ANTROPONIMET NË DY ROMANET HUMORISTIKE
TË DRITËRO AGOLLIT: *SHKËLQIMI DHE RËNIA E SHOKUT ZYLO*
DHE *ARKA E DJALLIT*

Për shkrimtarët e mëdhenj është e kuptueshme që të mos jenë “pre” e asnjë kornize, pasi ata zgjedhin me vetëdije “të thyejnë” me mënyra të tërthorta dhe përqeshëse rregullat dhe normat që përpiqen t’i mbajnë në të. Dikur komediani Molier sfidoi dhe shmangu rregullat e ngurta të Klasicizmit dhe këtë shmangie fatlume e realizoi vetëm nëpërmjet humorit. Në një kohë dhe vend tjetër, autori ynë Dritëro Agolli po nëpërmjet humorit do shmangë rregullat e ngurta të socrealizmit. Humori i hollë, me zigzake, herë therës dhe herë dashamirës, gjuha e pasur me leksik që herë zhytet në thellësitë e ligjërimit popullor, herë në thellësinë e mendimit të vet, bën që ky autor të sjellë një leksik nga të gjitha kohët dhe nga e gjithë hapësira shqiptare, por veçanërisht nga krahina e jugut, që është dhe vendlindja e tij.

Gjithashtu vërejmë që veprat e humorit nuk kanë kohë dhe hapësirë të caktuar, ato as mundesh t’i klasifikosh në drejtime dhe epoka letrare, pasi humori ka lindur qëkur ka lindur gjuha dhe nuk bëhet dot objekti i asnjë drejtimi apo pronë e asnjë grupi letrar, sepse ai është “pronë” e shpirtit të popujve dhe shkrimtarë të tillë si Molier apo shkrimtari ynë, që e huazuan prej shpirtit popullor ia kthyen atij këtë “borxh” me vepra universale dhe pa kohë.

“Unë kam ndiesinë se Dritëroi në krijimtarinë e vet priret kah e mira, larg ligësive, urrejtjeve, sharjeve e banaliteteve të kohës sonë. Dy shtyllat më të mëdha, që mbajnë thujse gjithë peshën e brendisë së veprës së tij, sipas meje janë *Shqipëria* (vendi, toka, fshati, rrugët, arat, fushat...) dhe *njerëzit* (baballarët, heronjtë, partizanët, miqtë, të varfrit...), të gjitha të vështuara me dashuri, me zemër të gjerë, me dëshirë të mirë, me shpresë të pashuar: *Mua më ndrit / Së largu veç shpresa*, - shkruan ai”¹.

Agolli e do njeriun dhe pozitivitetin e tij, por meqë nuk i do kornizat dhe skemat e imponuara, e shmangu heroin pozitiv të lodhur nga lëvdatat dhe e bëri shpeshherë qesharak, por tërheqës për të gjitha pritshmëritë.

Heronjtë e tij, janë jo vetëm mbartës të filozofisë popullore shqiptare, por janë dhe zëri i dilemës së tij me përmasa shpesh shekspiriane, që nëpërmjet humorit popullor do thonë atë që as vetë autori nuk e pranon ta thotë vetes, as me zë të ulët.

¹ J. Thomai, *Aromë popullore në ligjërimin poetik të Dritëro Agollit* - Kumtesë kushtuar D. Agollit në konferencën e organizuar nga Universiteti “Fan S. Noli” me rastin e 80-vjetorit të D. Agollit.

Shumë sjellje dhe veprime të heronjve, bien pre vetëm i kodit gjenetik të tyre dhe i filozofisë popullore dhe kursesi i rregullave të ngurta që iu serviren. Ata më të krisurit janë personazhet më të spikatur, që edhe emrin e kanë konform karakterit që i spikat: Cute Babulja, Bamkë Dynjaja, Hyskë Borobojka, Sherif Abëceja, Alush Karakanaqja, ashtu të zhurmshtëm dhe të çuditshëm të bëjnë të vësh buzën në gaz, me përbërjen tingullore të emërtimeve të tyre dhe trajtat e shkurtra të zgjedhura për të krijuar pikërisht efektin e duhur të lexuesi. Këta personazhe me gjithë dobësitë e tyre, janë tërheqës dhe aspak të lodhshëm, që lexuesi i do dhe qesh, sidomos me oreksin dhe shakatë e panginjura të Cute Babulja-s.

“Emrat e njerëzve dhe të vendeve shfaqen njëherazi me lindjen e gjuhës dhe shtohen, zhvillohen, ndryshojnë apo bien në harresë e dalin jashtë përdorimit, sipas rrethanave historiko-shoqërore dhe kulturore që përjeton popullsia përkatëse e çdo vendi. Jo më kot thuhet se mosha e emrave të vendeve dhe të njerëzve është aq e vjetër sa edhe vetë gjuha.”²

Kështu autori ynë ka ndjekur një traditë të hershme, të pëlqyeshme që nëpërmjet antroponimisë t’i jepet lexuesit një tregues për atë që përfaqësojnë disa personazhe: fshatin apo qytetin, përkatësinë fetare, shkollimin, profesionin, rolin që luajnë në rrethin shoqëror e letrar, etj. dhe gati të shumtën e herës e ka bërë këtë me anë të emërimit të tyre në mënyrë metaforike.

Kështu dukshëm personazhet femra dallojnë dukshëm nga prejardhja fshatare apo qytetare që kanë p.sh., Lulushja, Bajamja, Zenepja, Fatimja, kuptohen që janë nga fshati dhe akoma mbajnë emra të lidhura ngushtësisht me natyrën dhe mjedisin fshatar. Nga ana tjetër Anthulla, Adela, Kleopatra në përshtatje me mjedisin qytetar mbajnë emra të huaj ose modernë. Edhe trajtat e shkurtra -ja-, kanë pësuar shmangie dhe janë zëvendësuar me -a-, sa të duket sikur trajtat e normës letrare duken të vjetra dhe të dala kohe për emrat e qytetarëve.

Ndërsa përkatësia fetare nuk është kusht që t’i ndajë njerëzit në njerëz të mirë apo të këqij, të vegjël e meskinë, por i dallon nga emri, pavarësisht se emra si Marika, Taqi, Meropi, Jani, Telo, personazhe që përfaqësojnë njerëzit e qytetit dhe përkatësisht të Korçës, na krijojnë një ndjesi që i kemi njohur edhe më parë si njerëz mospërfillës ndaj të tjerëve, burrat të veshur me ato kostumet e mira dhe mustaqet spic, ndërsa gratë me biguditë në kokë, që pispilloren e ngjyhen.

Vizionar dhe me nuhatje të hollë, autori ynë ka respektuar traditën e autorëve të Rilindjes dhe nuk ka lejuar të përbuzë apo të ndajë njerëzit nga përkatësia fetare. Mes këtyre njerëzve të besimeve të ndryshme ka të mirë dhe të këqij: Telo, Taqi, Fore (Kristofori) janë njerëz të mirë dhe të dashur, ndonjëherë edhe më shumë se normalja, si p.sh., Telo është aq i dashur sa të duket naiv në dashurinë e tij për eprorin, ndërsa Mitro Karapataqi, me patronimin e krijuar posaçërisht me prapashtesën greke: -xi-, të duket sikur autori nuk do që një shqiptar të jetë kaq negativ dhe i prapë.

² P. Daka, *Emrat e njerëzve në gjuhën tonë*, “Gjuha Jonë”, 1, 1981, f. 105.

Antroponimet në dy romanet humoristike të Dritëro Agollit...

Patronimi ose emri i dytë në kohë të hershme ka qenë thjesht emri i babait, i cili merrte rolin e identifikimit të personit dhe familjes. Ka qenë i krijuar së shumti në rasën gjinore, p.sh., Gjergji i Gjonit ose me tre dhe katër gjymtyrë: Basho Gjeto Muji, Gjergj Elez Alia, etj. Po ta shohim në këtë rrjedhë, për afërsisht të gjithë personazhet në veprat e Agollit kanë njehsim të emrit dhe llagapit si tregues.

Sherif Abeceja – që prezantohet qysh në fillim të romanit “Arka e djallit” dhe në krye të fjalisë së faqes së parë, përveç njohjes që na bën autori për profesionin e tij, patronimi na ngjan më shumë me emërtim ose “llagap” dhe na tregon që ai është i lidhur ngushtësisht me këtë “zanat”. Nëse do e kthenim në gjinore si në traditën e hershme të emërtimeve që theksuam më sipër, do bëhej: Sherifi i Abece-së.

Gjithashtu në mënyrë metaforike ky antroponim na servir nëpërmjet humorit të hollë e të mistershëm një njeri të lidhur me shkronjat dhe të çuditshëm.

I kujdesshëm deri në “maniakësi” për të sjellë njerëz që qëndrojnë më afër natyrës dhe shpesh të “krisur”, që flasin gjuhën e saj dhe vendeve që i përkasin, krijon një rrëfim polifonik, me synimin e vetëm që të realizojë një komunikim estetik të gjerë në kohë dhe në lexues. Ai duke ndjekur me vëmendje semantikën dhe barazimin e saj me personazhet, i jep rrëfimit një barasvlefshmëri mes formës dhe përmbajtjes. Krijimet e emrave të personazheve shpesh me përmbajtje të dukshme semantike dhe lidhje të drejtpërdrejtë me “realen” ashtu si dhe pasurinë e temave dhe tipologjive letrare, Agolli do t’i pasurojë me të gjitha shtresat e leksikut, duke hulumtuar deri në thellësi gjithçka që do i shërbejë idesë së tij.

Po të shohim binomin Zylo dhe Demkë, i pari ka emër që mbaron me zanoren fundore -o, karakteristikë për të folmen e Devollit dhe Korçës, ndërsa Demka me prapashtesën zbunuese -kë. Prapashtesën zbunuese -kë e ndeshim dëndur në veprat e Agollit. “Mjaft të dëndura janë edhe trajtat e dyta të emrave vetjakë të formuar me prapashtesën -kë, sidomos në anët e Korçës e më gjerë në jug, si: Valkë nga Vali ose Valentina...”³.

Zylo-ja do ishte emërtimi në normën letrare, por në të gjithë romanin ai emërtohet vetëm shoku Zylo, me pak përjashtim, vetëm në rastet kur flet për të gruaja e tij, Adila. Sigurisht që idesë së autorit, i ka vajtur në ndihmë për ta shmangur normën edhe përdorimi i fjalës -shoku- Zylo, -shokut- Zylo, -shokun- Zylo, që siç shohim ndryshon mbaresat sipas rasës që lakohet.

Kjo shmangie nga norma letrare mendojmë se përshtatet me karakterin që përfaqëson, një njeri që i pëlqen të udhëheqë, zhurmëmadh dhe i pandryshueshëm në të gjithë romanin, e kundërta e Demkës, i cili me zbunimin e emrit qëndron si pjesa plotësuese e udhëheqësit të tij, i vogël dhe i përthyeshëm nga rrethanat dhe njeriu.

Nëse thellohem te kuptimet metaforike të antroponimeve dhe emrave të dyta, patronimeve, do të shohim një arsenal të tërë kuptimesh metaforike në vetëm këto dy vepra si:

³ Gj. Shkurtaj, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, shblu, Tiranë, 2001, f. 134.

- Kleopatra – emër i huaj dhe i njohur në histori, mbretëresha e Egjiptit një femër e zgjuar dhe udhëheqëse madhështore. Po njësoj edhe Kleopatra, gruaja e Adem Adashit, një femër e zgjuar si adashja e saj e lashtë dhe e bukur si perëndeshë, bëhet zilia e të gjithë burrave dhe grave në roman.

- E kundërta e saj është Adila, ky emër i ndryshuar nga emri -Dile, emër shqiptar i trevave të veriut, ka marrë parashtesën -a dhe ka ndryshuar zanoren fundore nga -e në -a, duke përfaqësuar një grua qytetare, sipërfaqësore, që kërkon vetëm të ruajë dukjen të familjes së lumtur dhe të suksesshme, me hipokrizi dhe shtrirje.

- Diogjeni – djali i tyre, mban edhe ky një emër grek, të poetit dhe muzikantit të antikitetit të lashtë, por kemi një krahasim qesëndisës, sepse ky fëmijë mburravec ashtu si prindërit e tij nuk ka lidhje me talentin e vërtetë, por është i kurdisur vetëm sipas dëshirave të tyre larg realitetit dhe pritshmërive.

- Patronimet si Shtufa – lëndë drusore e nxirrë, njësoj si personazhi që emërton, Sahatçiu -agronomi i ri i fshatit, që sikur sjell orën e re dhe rregullon të vjetrat.

- Gjithashtu një patronim me prejardhje greke: Arhitrari – që autori e quan mbiemër të vjetër, ka vërtet shpjegimin që ia jep edhe autori vetë: “trari kryesor” si “kryetari” i trarëve. Ky personazh është përgjegjësi i muzeut dhe ky patronim përqeshës e tall, sepse ai në të vërtetë nuk arrin të kryejë siç duhet punën që i është ngarkuar, jo më të jetë kryetari.

- Ndërsa rapsodët dhe kryepleqtë e fshatit, që përfaqësojnë traditën popullore dhe thelbin e saj i emërton me emra të parë dhe të dytë me lidhje semantike të dukshme: Tahir Kapedani, Gjok Çoku, Faslli Gropa, Jashar Guna, Koci Gjyle, që të trembin me mustaqet dhe emrat e tyre që herë të duken sikur të mbrojnë, herë sikur të bëjnë “gropën”.

- Maxhun Xhabalaku, ky emërtim i pamotivuar nga pikëpamja semantike, ka një ngarkesë të dukshme emocionale të ngarkuar me tinguj “kakofonë” dhe të shëmtuar si vetë njeriu që emërtohet me to.

Në një studim mbi fjalën shqipe, një studiues i njohur i saj, midis të tjerash vëren se shumë shkrimtarë dhe poetë, për t’u identifikuar me vendlindjen e tyre, sidomos ata që shkruan e punuan jashtë atdheut “... u shfaqën në botë me mbiemra të tillë si: Albanesi, Shqiptari, Shkodrani, Voskopojari, Gjirokastriti, etj. Të tjerë të kohëve më të reja, që përcaktuan edhe origjinalitetin dhe vlerat e kësaj kulture e të kësaj letërsie, përsëri i bënë jo vetëm pjesë organike të veprave të tyre por edhe i ripërmasuan. Veçohen këtu personalitete të tilla si Naim Frashëri (vëllezërit Frashëri), Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Lasgush Poradeci e të tjerë.”⁴

Ndërsa ne në këto dy romane vërejtëm që Dritëro Agolli, autor për të cilin dëndur pohohet që dëshiron që në veprat e veta të duket qartë “vula”e vendit nga është, në këto dy vepra nuk ka gati asnjë emërtim të mbështetur mbi toponimet e maleve, lumenjve apo fushave pafund të këtyre viseve të mrekullueshme. Ka emra

⁴ V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Përmbledhje artikujsh, botart, Tiranë, 2001, f. 219.

Antroponimet në dy romanet humoristike të Dritëro Agollit...

familjarë si: Thana, Bajamja, Karafillaku, etj., që lidhen ngushtë me mjedisin e fshatit, por askush nuk emërtohet: Selman Ziçishti, Adem Progri, Taqi Morava, Demkë Devolli, etj.

Këtë dukuri që përmendëm më sipër, gjithashtu dhe etnografinë e antroponimeve, jo vetëm të këtyre dy romaneve, por edhe të krejt veprës së Agollit dhe thellimin akoma më tej të interpretimit nga ana gjuhësore të antroponimeve të shumta me semantikë metaforike, mendojmë që mund të trajtohen në studime dhe kërkime të tjera shkencore, pasi dimë që këto kumtesa nuk mund të shpëtojnë tema kaq të gjera dhe voluminoze jo nga faqet, por nga polivalenca që shfaqin në çdo faqe.

